

URDHËR
Nr. 520, datë 3.12.2021

**PËR NDALIMIN E HYRJES NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË TË SHTETASVE
TË HUAJ ME HISTORI UDHËTIMI NË VENDET E AFRIKËS SË JUGUT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 7, pika 3, germa “a”, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar; si dhe në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri nr. 4881, datë 2.12.2021, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e hyrjes në Republikën e Shqipërisë të shtetasve të huaj me histori udhëtimi brenda 14 ditëve të fundit në vendet: Afrikë e Jugut, Kenia, Angola, Zambia, Bostwana, Senegal, Lesoto dhe Eswati, duke filluar nga data 3.12.2021 deri në datë 23.12.2021.

2. Vetëkarantinimin e detyrueshëm, për një periudhë 14-ditore, për personat rezidentë në Republikën e Shqipërisë, që vijnë në Shqipëri dhe kanë histori udhëtimi 14 ditët e fundit para mbërritjes, në vendet e përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhri.

3. Urdhri t'i përcillet ministrisë përgjegjëse për çështjet e jashtme, me qëllim njohjen e tij nga të gjitha përfaqësitë diplomatike në Republikën e Shqipërisë.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe organet kompetente për dhënien e masave administrative, sipas aktit normativ nr. 3, datë 15.3.2020, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu